

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E MARTË 11 TETOR 2022

Falënderoj zëvendësministret dhe përfaqësuesit e ministrisë për prezantimin!

Unë do të ndalem shkurtimisht, në mënyrë që të mos përsëris ato që u parashtruan nga zëvendësministrja. Ky projektligj është propozuar me qëllim ratifikimin e marrëveshjes së huas për financimin shtesë të projektit për zhvillimin e integruar urban dhe të turizmit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim me një shumë prej 30 milionë eurosh. Ky projekt i referohet projektit të integruar urban dhe turizmit që është pjesë e strategjisë afatgjatë të qeverisë shqiptare për të gjallëruar ekonominë vendore dhe jetën komunitare. Kuvendi në këtë moment ka miratuar marrjen e një huaje të mëparshme në vlerën 63,8 milionë euro nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Gjithashtu, ky projekt tani po implementohet në disa bashki të rajonit bregdetar, si zona e Vlorë-Sarandë dhe zonat në brendësi të Beratit, Gjirokastrës dhe Përmetit, të cilat janë përcaktuar nga qeveria si rajon prioritar dhe që i përket më tepër peizazhit, gjithashtu, aseteve të trashëgimisë kulturore. Nëpërmjet këtij projektligji të propozuar synohet të akordohet një shtesë financimi në masën 30 milionë euro të fokusuara kryesisht në zhvillimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e qendrave turistike dhe zhvillimin e tregut të produkteve turistike. Vlera e financimit shtesë do të përfundojë deri në datën 31 korrik 2025. Ky projektligj konsiderohet pjesë e dokumentit “Agjenda 2030” për zhvillimin e qëndrueshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së”, ku janë miratuar edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo marrëveshje prek dy nga këta objektiva:

- nxitjen e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë;
- ndërtimin e infrastrukturave rezistuese, nxitjen e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitjen e novacionit.

Meqenëse ne jemi komision përgjegjës dhe më tepër na interesojnë termat financiarë, theksoj se efektet në buxhetin e shtetit janë në masën 30 milionë euro, aq sa përcaktohet edhe shuma e huas. Interesi është i bazuar në normën e referencës plus marzhet e ndryshueshme ose sipas normës së përcaktuar të konvertimit. Tarifa front end fee është 0,25% e shumës së huas, komisioni i angazhimit është 0,25%, që përlogaritet mbi vlerën e 6 padisbursuar të huas dhe maturimi është 16 vjet, duke përfshirë periudhën prej 4 vjetësh pa pagesë principali. Në aspektin kushtetues ky projektligj është propozuar nga Këshilli i Ministrave, përfshirë në kategorinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, e përcaktuar në nenin 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në aspektin procedural projektligji është propozuar, gjithashtu, nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 81, pika 1 e Kushtetutës.

Gjithashtu, pavarësisht se i ftoj të gjithë kolegët për ta miratuar këtë marrëveshje huaje, kam disa pyetje. Nëse mundem, t'i bëj tani apo më vonë? Së pari, dua të pyes, pasi kjo është përzgjedhur nga qeveria, siç e kishim edhe në relacion, pse janë përzgjedhur këto zona apo bashki, siç është Bashkia Berat-Gjirokastrë, Përmet dhe Sarandë, sepse duket qartë që janë zgjedhur bashki të së njëjtës zonë, të zonës jugore? Pse nuk është parashikuar një politikë gjithëpërfshirëse për sa i përket shpërndarjes gjeografike? Pra, të jetë e balancuar, sepse shikohet që ka një diferencim krahinor. E dyta, ne jemi Komisioni i Ekonomisë dhe duam të dimë si janë shpenzuar fondet prej 63,8 milionë euro?

Në cilat fusha janë implementuar? A mund të kemi një informacion tabelor sipas fushave përkatëse, si, për shembull restaurim, ndërtim infrastrukture, punësim, iniciativa të tjera, ndriçim, rrugë të shtruara, që në këtë mënyrë të kërkohet një fond shtesë prej 30 milionë eurosh? Siç po kërkojmë informacion se si është shpenzuar fondi prej 63,8 milionë eurosh, në një moment të dytë do të kërkojmë informacion se si do të shpenzohen edhe 30 milionë eurot shtesë. Cili është destinacioni i përdorimit të fondit prej 30 milionë eurosh shtesë? Si do të shpërndahet ky fond nëpërmjet bashkive? Sa do t'i përkasin Bashkisë së Gjirokastrës, të Beratit, Përmetit, Vlorës, pasi ne kemi një informacion të përgjithshëm që fondi prej 30 milionë eurosh do të fokusohet në rivitalizim.

Kjo është në vazhdim të financimit të mëparshëm prej 63,8 milionë eurosh, duke kryer urë lidhëse për zhvillimin në zona të tjera turistike? A ka rivitalizim të projektit "100 fshatrat" që preket nga ky fond? Pra, në pjesën e kësaj marrëveshjeje huaje, a bën pjesë edhe projekti "100 fshatrat", i cili, me sa duket, ka ngelur në mes? A kemi të dhëna statistikore se sa impakt ka krijuar në zonat ku është investuar fondi prej 63,8 milionë eurosh i financuar më parë? Si është përkthyer ky fond në punësim, në infrastrukturë, në zhvillimin urban, në zhvillimin kulturor apo tradicional të trashëgimisë kulturore në zonat ku është

investuar, duke u përkthyer edhe në punësim apo në zhvillim të bizneseve të zonës? A është parashikuar në këtë fond ndonjë projekt për formimin profesional, sepse pavarësisht investimeve në infrastrukturë apo në asete të tjera që mund të bëhen, burimet njerëzore janë aseti më kryesor që rivitalizon çdo investim infrastrukturor apo në fushën e turizmit që ne mund të bëjmë?

Kjo kredi është miratuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe çdo shpenzim i kryer në fondin e parë prej 63,8 milionë eurosh janë të detajuara, sepse ata i kalojnë nëpërmjet një filtri të thelluar, por ne si Komisioni përgjegjës për Ekonominë do të donim të kishim një informacion se si janë shpenzuar këto fonde dhe destinacioni ku është kryer. Patjetër që këto fonde menaxhohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili ka pasur sukses në të gjitha projektet që ka marrë për zbatim.

Pavarësisht të gjithave, ne jemi plotësisht dakord të miratojmë çdo lloj marrëveshjeje huaje që çon në rivitalizim, në zhvillim kulturor dhe komunitar ndërmjet vendeve apo fuqizimin ekonomik të jetës komunitare në vendet që investohet. Nuk e di nëse arritët t'i mbanit shënim të gjitha pyetjet, por mund t'i ripërsëris nëse ndonjëra prej tyre nuk është mbajtur. Faleminderit!